

VENDIM
Nr.252, datë 15.5.2009

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR “PËR
HETIMIN E PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE TË DHËNIES SË LEJEVE TË
NDËRTIMIT NË BASHKINË E TIRANËS”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT
NR.249, DATË 23.4.2009**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002
“Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet raporti përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Dërgohet raporti përfundimtar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale për personat që eventalisht kanë abuzuar me detyrën dhe funksionin publik.

III. Konstatohet pavlefshmëria e vendimeve të KRRT-së së Bashkisë së Tiranës së datës 17 prill 2009 dhe ngarkohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive që, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të ndërmarrin masat ligjore në përputhje me nenin 40 pika 6 shkronja “b” të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)